



Prishtinë, 13 prill 2017
Kodi i ZRRE-së: V_911_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin e datës 23 shkurt 2017 për licencim të aktivitetit të importit, eksportit dhe transitit të energjisë elektrike (në vazhdim licencim i aktivitetit për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike), të bërë nga ndërmarrja "MTSP KOSOVO" L.L.C., adresa: Rr. Bedri Pejani Nr 3, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 13 prill 2017, nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes "MTSP KOSOVO" L.L.C., me numër licence ZRRE/Li_58/17 për periudhën nga data 13 prill 2017 deri 12 prill 2022.**

Arsyetim


- a) Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 23.02.2017 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, nga ndërmarrja MTSP Kosovo L.L.C.
- b) Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave/dëshmime të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim të këtij aktiviteti, si dhe ka kërkuar disa dokumente shtesë, të cilat janë sjellë në Rregullator.
- c) Rregullatori i lëshon kësaj ndërmarrjeje licencë për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, pasi që Ligji Nr. 05/L-084 i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016 parasheh një aktivitet të tillë.





- d) Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmive të kërkuara sipas aplikacionit, Rregullatori ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Krenar Bujupi, U.D kryesues


Arsim Janova, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit "MTSP KOSOVO" L.L.C
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe
- Departamentit Ligjor dhe të Licencimit-ZRRE